



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 180 prot

Tiranë, më 04 3 2024.

**VENDIM**

Nr. 1 datë 04.3.2024

**PËR**  
**MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E**  
**KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE**  
**VENDORE TË DATËS 19/2/2024**

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në VKM nr.910, datë 21.12.2016, “Për çështjet objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, të mbledhjes së datës 19.2.2024 vendosi:

1. Për projektligjin “**Për sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit e trajtimit të ujrale të ndotur urban**”, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Enerjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucionit propozues si më poshtë:
  - Neni 5, gërmë “c” të ndryshohet si vijon:
  - “për personat që ushtrojnë veprimitari tregtare të shitjes së ujit të pijshëm të ambalazhuar të cilët nuk furnizohen nga rrjeti i administruar nga operatorët e ujësjellës kanalizimeve, por marrin ujë me leje apo autorizim nga organet e administrimit të ujit drejtësuar nga burimi ujor”;
  - Të shtohet gërmë “ç”, me përbajtjen: “Për sistemet e largimit të ujrale të shiut”.
  - Neni 11, dhe neni 12 ka mbivendosje emërtimesh të institucionit:

- “Agjencia përgjegjëse për burimet ujore” apo “agjencia kombëtare përgjegjëse për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin, grumbullimin e trajtimin e ujërave të ndotur urban”;
  - Të shtohet gërrma “e”, “agjencia monitoron dhe vlerëson ecurinë e indikatorëve të përfomancës”.
  - Neni 14, “Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV)”, të shtohet gërrma “j” si vijon: “Vendimmarjen për amnistinë e detyrimeve të prapambetura dhe kamattonesave, për rastet kur organet e qeverisjes vendore janë 100% aksionerë të operatorëve të ujësjellës kanalizimeve”;
  - Nenin 15, pika 2 të ndryshohet si vijon: “Statusi tip i operatorëve të furnizimit me ujë miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave”;
  - Neni 22, në fund të pikës 1 të shtohet: “...kur ky aggregim rezulton fizibel”;
  - Neni 25, pika 2 të ndryshohet si vijon: “Studimi përkatës i fizibilitetit i kryer nga NJVV-të përkatëse për dhënien me koncession, ose nëpërmjet një marrëveshje të partneritetit publik privat miratohet nga këshillat e NJVV-ve dhe parimisht nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe nga ERRU-ja, brenda 3 muajve nga paraqitja e tij”;
  - Neni 25, “marrëveshjet koncessionare dhe partneriteti publik privat” të miratohen me Vendim të Këshillit Bashkiak”;
  - Neni 27, pika 3, gërrma “d” dhe “f”, të specifikohen kushtet kur aplikohet ky parashikim, ndërsa afatet janë të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative;
  - Neni 29, pika 1, gërrma “b”, të saktësohet termi “deri te konsumatori” në.... “deri te matësi i konsumatorit”;
  - Neni 34, pika 4, të përcaktohet deri ku është përgjegjësia “te matësi apo pika e lidhjes”;
  - Neni 35, “marrëveshja” të zëvendësohet me termin “kontrata e furnizimit”, referuar nenit 772 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
  - Neni 37, pika 2, të shtohet germa “d” me këtë përbajtje: “kur konsumatori nuk e lejon operatorin të vendosë ujëmatës në objekt”;
  - Neni 42, “Faturimi” të shtohet “titull ekzekutiv”;
  - Neni 75, “Sanksionet Administrative” të përfshihen “subjektet që tregëtojnë ujë të pijshëm të paliçensuar nga ERRU”;
  - Neni 76, “Ankimimi”, në pikën 1 të shtohen “konsumatorët mund të ankimojnë vendimin e ERRU-së në Gjykatën Administrative Tiranë”;
  - Neni 78, “Të Drejtat e Pronësisë” pika 5 është kontradiktore me nenin 34 pika 4 në lidhje me përgjegjësinë e konsumatorit dhe të administratorit të godinës.
2. Për projektvendimin **“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”**, propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehëndakordësinë në parim me projektvendimin.
3. Për projektligjin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016, “Për prefektin e qarkut”**, propozuar nga Ministria e Brendshme, anëtarët e Këshillit

Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Neni 4, pika 1, “akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhërat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridikzionit të organit të vetëqeverisjes vendore” është i panevojshëm pasi përkufizimi i këtij koncepti ligjor parashikohet në ligjin specifik të KPRA-së, nen 3/2;
- Të saktësohet përcaktimi i akteve normative të NJVV-ve si objekt verifikimi i ligjshmërisë nga prefekti;
- Të parashikohen në buxhet kostot për ngritjen e KVSP-ve.

4. Për draftin e “**Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030**”, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Pika A1.3.2, të përfshihen edhe fëmijët në kategoritë për të cilën do hartohen udhëzues dhe protokolle në raste krizash apo emergjencash;
  - Pika B2.2.3, të akreditohen krahas ofruesve të programeve të trajnimit dhe edukimit edhe psikologët;
  - Pika A3.2.8, të specifikohet nëse planveprimi për garancinë e fëmijëve është në një linjë me Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve;
  - Pika A1.1.6, të specifikohet që viktimat e dhunës në familje me UM mund të përfitojnë vetëm njëren pagesë, ose NE-në ose pagesën e UM-së.
5. Për projektvendimin “**Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2024-2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj**”, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
6. Për projektvendimin “**Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror**”, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Pika 7 të formulohet si vijon: “.... struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në NJVV bashkërendon planet sociale vendore 3-vjeçare, të njësive administrative në territorin e saj, si dhe planin social rajonal me planet sociale të NJVV-ve. Kur vlerëson që ekzistojnë kushtet që një apo disa shërbime që përmbushin nevojat e dy apo më shumë njësive administrative, apo dy apo më shumë NJVV, kryen përllogaritjen e kostos së aktiviteteve dhe ia paraqet për miratim këshillit bashkiak/të qarkut, pas konsultimit të tij me Drejtorinë Rjonale të Shërbimit Social Shtetëror...”;

- Pika 10, të formulohet si vijon: “.... NJVV-të bazuar në planet sociale vendore/rajonale përgatisin kërkesat për financim të Fondit Social, të miratuara nga këshillat bashkiak/të qarkut nga buxheti i shtetit të vitit të ardhshëm....”;
  - Pika 15, të formulohet si vijon: “...në kuptim të këtij vendimi, kategoritë e aktiviteteve/shpenzimeve që mbështeten nga Fondi Social, për shërbimet e specializuara në nivel qarku, janë fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore të strukturës/stafeve sociale në qark si dhe stafeve sociale të OFJ-ve ofruese të shërbimit sipas marrëveshjeve përkatëse, dhe rast pas rasti fondeve për shpenzime ushqimore për përfituesit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi....”.
  - Të shtohet numri i personelit administrativ i këshillit të qarkut, ku sipas përcaktimeve të ligjit të buxhetit të shtetit të çdo viti, neni 15 pika 4, nuk mund të jetë më shumë se 10 punonjës.
7. Për projektvendimin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.111, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”**, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjtjes Sociale, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të përcaktohen aktivitetet ku është përgjegjëse pushteti vendor;
  - Të përcakohen afatet kohore si dhe kostot e burimit të mbulimit të financimit.
8. Për projektvendimin **“Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyera në fond banese të papravatizuara”**, propozuar nga Ministria e Financave, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Nenit 1, të rishikohet baza ligjore sepse dispozita referon tek neni 77, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr.22/2018, e cila nuk është vendosur tek baza ligjore e draft vendimit;
  - Neni 3, lidhur me procedurën, të referohen në draftvendim afatet brenda të cilave NJVV ose EKB do të kërkojnë kalimin në pronësi të objekteve që do ti nënshtronen procesit të privatizimit;
  - Kreu II, pika 5 parashikon rastet kur nuk mund të kryhet privatizimi i banesave, ndërsa kreu II, pika 1, shkronja “b”, ku NJVQV apo EKB kanë detyrimin të konfirmojnë që objekti i kthyer në banesë që do të provatizohet ndodhet brenda një zone ku nuk parashikohet të kryhet një investim publik ose nuk parashikohen ndërtime më të larta se 5 kate, nuk parashikohet në draftvendim;
  - Kreu V, pika 8, duhet të mos përcaktohet destinacioni i fondeve që mund të përdoret nga NJVV, fonde që shkojnë në buxhetin e tyre të vendosin vet bashkitë lidhur me përdorimin e tyre.
9. Për projektvendimin **“Për një ndryshim në vendimin nr.600, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Nenit 1, të rishikohet baza ligjore sepse dispozita referon tek nenit 77, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr.22/2018, e cila nuk është vendosur tek baza ligjore e draft vendimit;
- Neni 3, lidhur me procedurën, të referohen në draftvendim afatet brenda të cilave NJVV-të ose EKB do të kërkojnë kalimin në pronësi të objekteve që do ti nënshtrohen procesit të privatizimit;
- Kreu II, pika 5 parashikon rastet kur nuk mund të kryhet privatizimi i banesave, ndërsa kreu II, pika 1, shkronja “b”, ku NJVV-të apo EKB kanë detyrimin të konfirmojnë që objekti i kthyer në banesë që do të privatizohet ndodhet brenda një zone ku nuk parashikohet të kryhet një investim publik ose nuk parashikohen ndërtime më të larta se 5 kate, nuk parashikohet në draftvendim;
- Kreu V, pika 8, duhet të mos përcaktohet destinacioni i fondeve që mund të përdoret nga NJVV-ja, fondeet që shkojnë në buxhetin e tyre të vendosin vetë bashkitë lidhur me përdorimin e tyre.

**Z. Arbjan MAZNIKU**  
**Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor**

Bashkëkryetar



**Z. Aldrin DALIPI**  
**Kryetar i Shoqatës së Këshillit**  
**të Qarqeve të Shqipërisë**  
**Bashkëkryetar**

